



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 664/5 Prot

Tiranë, më 19.10.2020

V E N D I M

Nr.125, datë 19.10.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të informacionit të përcjellë me shkresën nr. 664 prot., datë 12.8.2020, prej nëpunësit *** , në lidhje me disa pretendime për procedurën e lirimit nga detyra, për shkak ristrukturimi**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë nga nëpunësi ***** , për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të lirimit nga detyra, për shkak ristrukturimi,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës nr. 664 prot., datë 12.8.2020, nëpunësi ***** ka informuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me disa pretendime të tij, për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të lirimit nga detyra, për shkak ristrukturimi.

Nga verifikimi i kryer në këtë rast, rezulton se punonjësi ***** , ka përfutuar statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Pronave Publike dhe Pyjeve”, pranë Bashkisë Vorë (me aktin nr. 134/6, datë 15.04.2015 të njësisë përgjegjëse), detyrë të cilën ka vijuar ta kryejë deri në momentin kur, me vendimin nr. 88,

datë 24.07.2020 “Për deklarimin e lirimit nga shërbimi civil”, është liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Procesi i ristrukturimit është kryer mbi bazën e urdhrit nr. 110, datë 04.06.2020 “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Vorë dhe njësisë administrative për vitin 2020” me të cilin Kryetari i Bashkisë Vorë, ka miratuar strukturën e re, që është shoqëruar me ndryshime në organizimin e të gjithë institucionit, duke përfshirë edhe strukturën organizative ku ka qenë punësuar nëpunësi në fjalë.

Në vijim, Komisioni i Ristrukturimit, pasi ka shqyrtuar dhe krahasuar strukturat përkatëse, ka dalë me propozimet për sistemimin e atyre nëpunësve që mund të mbaheshin në kuadër të strukturës së re dhe lirimin nga shërbimi civil të atyre nëpunësve që u ishte shkurtuar pozicioni i punës dhe nuk mund të sistemoheshin në pozicionet e lira.

Konkretisht, për rastin e nëpunësit në fjalë komisioni ka konstatuar që, “Sektori i Pyjeve” në strukturën e vjetër ishte pjesë e “Drejtorisë së Pronave Publike dhe Pyjeve” dhe kishte në përbërje 1 përgjegjës dhe 4 specialistë, ndërsa në strukturën e re ky sektor ka në përbërje vetëm 2 specialistë, në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Bujqësisë dhe Veterinarisë. Siç shihet, kemi përgjysmim të numrit të specialistëve të pronave publike dhe pyjeve, gjë e cila hedh poshtë pretendimin e ngritur se në strukturën e re nuk ka ulje të numrit të punonjësve.

Duke qenë se ky ristrukturim është karakterizuar nga pakësimi i njësisë organizative dhe bashkimi ose shkrirja e tyre, ka patur edhe ndryshime të përshkrimit të pozicioneve të punës dhe të kërkesave të veçanta për këto pozicione të mbetura apo krijuar rishtas. Kjo ka bërë që një pjesë e nëpunësve, ku është përfshirë edhe kërkuesi *****, në pamundësi sistemimi, janë liruar nga shërbimi civil, në kushtet e pikave 6, 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procesit të verifikimit të këtij rasti, me anë të shkresës së regjistruar me nr. 664/3, datë 01.10.2020, Komisioneri është njoftuar nga institucioni i Bashkisë Vorë se, pasi është bërë vlerësimi i kriterëve dhe kërkesave të veçanta, për pozicionet e reja të krijuara, ka filluar procesin e konkurrimit për plotësimin e tyre, proces në të cilin, bazuar në të drejtën që njeh pika 8/a, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka kërkuar të konkurrojë edhe nëpunësi *****, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele.

Nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se veprimet e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Vorë si në procesin e ristrukturimit, ashtu dhe në atë të plotësimit të pozicioneve të lira, ka vepruar në përmbushje të rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të kërkesës me nr. 664 prot., datë 12.8.2020, dërguar nga ana e nëpunësit *****, në lidhje me pretendimet e ngritura, për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Vorë dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha